



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

Ref: 413/Q/2022
Datë: 13/09/2022

RAPORT

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve te OJQ-ve qe kontribuojnë në :

- 1) Analizën e situatës nga aspekti gjinor i pozitës se grave të dënuara për dhunën ne familje duke përfshiri politikat ndëshkimore për rastet r grave-dhunuese.
- 2) Realizimi i hulumtimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave ne pozitat vendimmarrëse ne sektorin publik dhe privat.

Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje publike me 17.08.2022 për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht analizave gjinore dhe hulumtimeve që analizojnë gjendjen e grave dhe burrave sipas objektivave Strategjike

Shtylla III: Te drejtat e grave ,qasja ne drejtësi dhe siguria.

- 1) Analizën e situatës nga aspekti gjinor i pozitës se grave të dënuara për dhunën ne familje duke përfshiri politikat ndëshkimore për rastet r grave-dhunuese.
- 2) Realizimi i hulumtimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave ne pozitat vendimmarrëse ne sektorin publik dhe privat.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thinje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendim marrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej shtatë(7) Organizata Jo Qeveritare të cilat para vlerësimit të projekteve të tyre komisioni ka bere kontrollin administrativ te secilit aplikacion.

Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike janë:

1. **D4D** – Emri i Projektit:”Barrierat dhe Paragjykimet: Statusi i Grave ne pozita udhëheqëse ne Kosove”.
2. **IRA** -Emri i Projektit:”Hulumtim mbi përfshirjen e grave dhe vajzave ne pozita vendimmarrëse ne institucionet publike lokale ne komunën e Gjilanit dhe Kamenicës”.
- 3 . **Instituti Riinvest** -Emri i projektit:”Roli i grave ne pozitat vendimmarrëse në sektorin publik dhe privat në Kosove”.
- 4 . **Rinia e Mitrovicës Aktive** – Emri i projektit :”Dhuna ndaj grave në familje”.
5. **Women World Today and Now(WWTN)**-Emri i Projektit:”Gratë ne procesin e Vendimmarrjes në Kosovë”.
6. **Roma Versitas Kosova** -Emri i projektit-“Barazia për gratë Rome” .
7. **Qendra e Rinisë Drenas** – Emri i Projektit :”Barazia Gjinore për gratë në zonën rurale”.

Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr. të vendimit 406/2022 i përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm, kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.

Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas thirrjes publike dhe kritereve; a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike të cilat ishin baza për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores MF-Nr.04/2017, komisioni ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim se projekt” Roli i grave ne pozitat vendimmarrëse në sektorin publik dhe privat në Kosove”nga”Instituti Riinvest “ka plotësuar në tërësi kriteret e parapara me nenin 10 dhe 11

të Rregullores MF-Nr.04/2017 kriteret e thirrjes publike; a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike dhe si e tille kualifikohet per financim.

Anetarët e Komisionit

Adelina Kajtazi-Kryesuese *A. Kajtazi*

Fitore Gashi -Anëtare

Besa Zogaj Gashi-Anëtare

Leonora Selmani - Anëtare

Rexhep Gojnovci-Anëtar

